

Po vjen një epokë e re. Bëhu gati!



## DSSH/ASD DITËT E STUDIMEVE SHQIPTARE / 2016

albanian studies days / journées d'études albanais

UET / 29-30 Prill 2016

**Tema: "SHQIPËRIA SI OBJEKT STUDIMI: EKONOMIA, POLITIKA, ZHVILLIMI SOCIAL, E ARDHMJA"**

Konferencë ndërkombëtare shkencore / International scientific conference



Mozaiiku i Tiranës, shek. III A.D.

Në partneritet me:



Adresa: Bulevardi Gjergj Fishta, Nd. 70, H.1, Tiranë, Cel. 068 20 16 616, info@uet.edu.al, www.uet.edu.al



## DSSH / ASD 2016

### Të studiojmë Shqipërinë – ekonominë, politikën, zhvillimin social, të ardhmen



**Prof. Dr. Adrian Civici**

Presidenti i UET

Ditët e Studimeve Shqiptare, në sesionin e tretë të tyre në vitin 2016 kanë një këndvështrim e fokus të veçantë. Brenda filozofisë dhe qëllimit të tyre si një festival idesh, debatesh e studimesh shkencore, këtë herë, DSSH do t'i kushtohen "Studimit të Shqipërisë – ekonomisë, politikës, zhvillimit social, të ardhmes" së saj. Në një tërësi aktivitete, konferencave shkencore, tryeza debatesh, botime e promovime librash e revistash, ekspozita të ndryshme, etj., problematika shqiptare, e sotmja dhe sfidat e të ardhmes do ti nënshtrohen një skanerit akademik, analizues e shkencor për të kuptuar se çfarë është bërë mirë dhe çfarë nuk ka ecur si duhet, për të qenë të bindur se çfarë oportunitetesh dhe pengesash na ka vënë përpara aktualiteti, dhe mbi të gjitha, çfarë duhet propozuar e bërë për të ardhmen që të kemi një ekonomi të qëndrueshme, që politika dhe demokracia të jenë sa më reale e eficiente në funksion të zhvillimit dhe integritetit, që zhvillimi social të reflektojë sa më shumë mirëqenie, barazi, mbështetje sociale, perspektivë sociale, modernitet.

E veçanta e këtij sesioni të DSSH qëndron në faktin, se detyra e studimit të Shqipërisë dhe problematikës së saj do t'i besohet veçanërisht universitarëve, studiuesve dhe akademikëve shqiptarë që studiojnë dhe punojnë në universitete e qendra kërkimore në shumë vende të botës, veçanërisht në universitete e institute shkencore perëndimore në BE, vende të OECD, etj. Tashmë, egziston një numër i madh intelektualësh, studiuesish, akademikësh e studentësh shqiptarë në qendra studimore e akademike prestigjioze, në institucione të mirënjohura ndërkombëtare, të cilët, në bashkëpunim me universitete, pedagogë e kërkues që punojnë në Shqipëri mund të realizojnë një analizë cilësorë të realitetit dhe sfidave të Shqipërisë për një apo dy dekadat e ardhshme. Jemi mësuar të vlerësojmë e besojmë më shumë studimet dhe zgjidhjet që na vijnë nga studiues apo institucione të huaja partnere. Ka ardhur momenti që krahas tyre të stimulojmë, angazhojmë e mbështesim shumë më tepër se deri tani mendimin shkencor shqiptar.

UET që tashmë ka grumbulluar një eksperiencë të çmuar në kërkimin shkencor, debatin e ideve dhe sintezën e përvojës akademike, që e ka strategji e filozofi kryesore të aktivitetit të tij "shkencën në funksion të progresit politik, ekonomik e social", "analizën dhe kërkimin në funksion të biznesit dhe zhvillimit të qëndrueshëm", vlerëson se angazhimi i ekselencës akademike e intelektuale shqiptare jashtë vendit në studimin e çështjeve thelbësore që kushtëzojnë dhe orientojnë zhvillimin perspektiv të Shqipërisë, është kontribut pozitiv në favor të Shqipërisë dhe gjithë shqiptarëve. Ideja e krijimit dhe konsolidimit të një rrjeti "UET – shkencë - progres" me kërkues shqiptarë në vend dhe kudo në botë do kontribuojë që politika, ekonomia, zhvillimi social dhe e ardhmja e Shqipërisë të jenë më cilësore, më të qëndrueshme dhe në sintoni të plotë me objektivin tonë madhor të integritetit evropian dhe zhvillimet e progresin bashkëkohor.

Besoj se DSSH 2016 do ngjallin interesin maksimal në rrjetet dhe komunitetin e kërkuesve shqiptarë, që shumë prej tyre do t'i bashkëngjiten kësaj sipërmarrje të rëndësishme shkencore e debati, në mënyrë që rezultati final që shprejsojmë të gjithë të jenë sa më shumë konkluzione e receta në favor të zhvillimit ekonomiko-social të Shqipërisë në dekadat e ardhshme.



# DSSH / ASD

## Udhërrëfyes i shkurtër i Ditëve të Studimeve Shqiptare

**PSE DSSH:** Ditët e studimeve shqiptare është një tërësi konferencash shkencore ndërkombëtare të ndërtuara me sistemin e "peer review" për të debatuar sipas fushave të ndryshme në lidhje me problematikën e shoqërisë shqiptare, të ekonomisë, të institucioneve juridike, debateve historike, mediave, institucioneve politike, politikave publike apo të zhvillimit të edukimit dhe arsimit, impakteve në zhvillimin shqiptar dhe politikave publike.

### PJESËMARRËSIT:

- Studuesve të huaj të cilët kanë objekt dhe fokus të studimeve të tyre ose punimeve të tyre doktrale Shqipërinë.
- Pedagogëve shqiptarë të cilët punojnë në universitetet perëndimore prej viteve '90 ose më parë, dhe që kanë e vazhdojnë të kenë Shqipërinë si objekt të tyre të studimeve.
- Doktorantëve të huaj që kanë një temë të tyre për Shqipërinë
- Doktorantëve shqiptarë të cilët ndodhen në universitetet perëndimore, që kanë për temë studimi një temë që lidhet me Shqipërinë apo me rajonin.
- Doktorantëve të UET të cilët kanë nevojë të takojnë komunitetin shkencor përkatës.
- DSSH është veprimtaria kryesore shkencore e tetë departamenteve të UET, e trupës së saj akademike dhe studentëve më të shkëlqyer të nivelit master shkencor.

**KOHA:** Aktiviteti do të organizohet çdo fund muaji prill dhe do të jetë i ndarë në 5 konferenca sipas problematikës dhe departamenteve të cilat i kanë miratuar komunitetet shkencore të konferencës.

*(shih programin bashkëngjitur)*

**KALENDARI I AKTIVITETEVE:** Aktiviteti do të përmbajë gjithashtu një numër aktiviteteve të tjera (shih programin jashtë konferencës), pikërisht me elementë që përbëjnë jetën shkencore dhe produktin shkencor siç janë: promovimi i librave dhe debati për to, dokumentarë, ekspozita fotografish apo dokumentarë të cilët ilustronë problematikën e studimeve shqiptare.

Mirë se vini në Ditët e Studimeve Shqiptare!

## PROGRAMI

**Konferencë ndërkombëtare shkencore:** "Shqipëria si objekt studimi: Ekonomia, Politika, Zhvillimi Social, e Ardhmja"

**28 PRILL 2016** Pritja e lektorëve të huaj/pjesëmarrësve

**29 PRILL 2016** Ora 18:00 Hapja e konferencës, përshëndetjet e drejtuesëve dhe të ftuarëve

**30 PRILL 2016** Ora 10:00-13:00 Sesioni i parë i konferencave; Ora 14:00-17:00 Sesioni i dytë i konferencave

**Komiteti Shkencor i Konferencës:** Prof. Dr. Adrian Civici - Kryetar

Prof. Dr. Tonin Gjuraj, Prof. Dr. Luljeta Minxhozi, Prof. Dr. Përparim Fuga, Prof. Dr. Ferit Duka,

Prof. Dr. Romeo Gurakuqi, Prof. Dr. Ksenofon Krisafi, Henri Cili (PhD), Prof. Asoc. Dr. Arbi Agalliu, Prof. Stefano Bianchini,

Prof. Francois Lerin, Prof. Guglielmo Chiodi, Prof. Miro Hacek, Prof. Paul G. Nixon, Prof. Kornely Kakachia

**Koordinator Organizativ:** Prof. Asoc. Dr. Arbi Agalliu/ **Ndihmës Koordinatorë:** Dokt. Besarta Vladi

## SEKSIONET E KONFERENCËS

### ■ Departamenti Financës & Ekonomiks

#### “Reformat strukturore dhe sfidat e integritetit”

Komiteti Shkencor për panelin e Financës: Prof. Asoc. Dr. Elvin Meka; Prof. Dr. Magdalena Bregasi; Prof. Asoc. Dr. Anilda Bozdo

Komiteti Shkencor për panelin e Ekonomiks: Prof. Asoc. Dr. Eniel Ninka, Prof. Asoc. Dr. Mateo Spaho, Dr. Besart Kadia

Sekretaria Organizative: Dokt. Elona Shehu

### ■ Departamenti Menaxhim

#### “Menaxhimi i kompanive shqiptare në periudhë recensionit.”

Komiteti Shkencor: Prof. Dr. Drita Kruja; Prof. Asoc. Dr. Ermira Qosja; Prof. Asoc. Dr. Arlinda Ymeraj; Prof. Asoc. Dr. Oltjana Zoto; PHD. Elena Kokthi

Sekretaria Organizative: Dr. Elvira Tabaku; Dokt. Denisa Mamillo

### ■ Departamenti Informatikës, Matematikës, Statistikës

#### “Aplikimet e Teknologjisë së informacionit në Ekonomi, Biznes dhe Shoqëri”

Komiteti Shkencor: Prof. Asoc. Dr. Indrit Baholli, Prof. Dr. Adriana Gjonaj, Mimoza Durrresi, PhD, Prof. Asoc. Dr. Hysen Binjaku, Dr.

Ani Sharko, Dr. Teuta XHINDI, Dokt. Gentjan Hoxhalli

Sekretaria Organizative: Dokt. Erind Hoti, Dokt. Ledina Kateri

### ■ Departamenti e Drejtë Private

#### “Zhvillimet e fundit në të drejtën private”

Komiteti Shkencor: Prof. Asoc. Dr. Migena Leskoviku; Prof. Asoc. Dr. Edi Spaho; Prof. Asoc. Endira Bushati; Prof. Asoc. Dr. Juelda Lamce

Sekretaria Organizative: tbc

### ■ Departamenti e Drejtë Publike

#### “Të drejtat dhe liritë themelore përballë pushtetit publik në Shqipëri”

Komiteti Shkencor: Prof. Dr. Ksenofon Krisafi; Prof. Asoc. Dr. Migena Leskoviku; Prof. Dr. Romeo Gurakuqi; Phd. Mirgen Prence

Sekretaria Organizative: tbc

### ■ Departamenti Edukimit

#### “Sfida psiko-pedagogjike të reformimit të arsimit shqiptar, nga masivizimi drejt cilësisë”.

Komiteti Shkencor: Prof. Asoc. Dr. Tomi Treska, Prof. Asoc. Dr. Ylljet Aliçka, PhD. Erika Melonashi;

Sekretaria Organizative: Valbona Nathanaili (Dokt.)

### ■ Departamenti Shkencat Sociale të Aplikuara

#### Paneli Marrëdhënie Ndërkombatare “Migrimi dhe çështjet identitare dje dhe sot.”

#### Paneli Shkenca Politike: “Përfaqësimi, politika dhe antipolitika”

Komiteti Shkencor: Prof. Dr. Ferit Duka, Prof. Dr. Përparim Fuga, Dr. Roland Lami, Prof. Dr. Kristaq Xharo, Dr. Enri Hide,

Sekretaria Organizative: Ervis Iljazaj, PhD

### ■ Departamenti Marrëdhënie Publike dhe Komunikimit

#### “Të komunikosh Shqipërinë përmes medimeve të sotme politike, kulturore dhe sociale.”

Komiteti Shkencor: Prof. Dr. Aleksander Dhima, Prof. Asoc. Belina Budini, Lorena Licenji PhD, Gilman Bakalli PhD, Henri Cili PhD

Sekretaria Organizative: Dr. Irena Myzeqari

Seksionet e konferencës sipas departamenteve do të zhvillohen në datën 30 prill, ora 10.00 – 13.00, 14:00 - 17:00

Struktura e pjesëmarrësve në konferencat e departamenteve: 1 keynote Speaker; 1 akademik shqiptar ose i huaj; 3 pedagogë të

departamenteve ose 3 kumtesa ku mund të marrin pjesë nga 2 apo 3 pedagogë; 2 profesorë nga Prishtina dhe Maqedonia, 3-5 doktorantë;

Mund të pranohen edhe 5-6 punime në formë posterit për çdo konferencë departamenti.

## DATA TË RËNDËSISHME

30/09/2015	Shpërndarja e thirrjes
29/01/2016	Afati përfundimtar i dorëzimit të abstraktit
19/02/2016	Konfirmimi i pranimit të abstraktit
31/03/2016	Afati përfundimtar i dorëzimit të punimit të plotë
11/04/2016	Konfirmimi i pranimit të punimit të plotë

Pagesa për pjesëmarrje (referim/poster): 50 euro / autor. BKT: U.E.T shpk IBAN euro: AL 11 2051 1519 4255 40CL TJCF EURA

Dërgoni aplikimet ose kërkonini më shumë informacion në: [dssh@uet.edu.al](mailto:dssh@uet.edu.al); tel: Arbi Agalliu +355 68 90 27 154

NE JEMI KUDO!



## DSSH/ASD DITËT E STUDIMEVE SHQIPTARE /2014

albanian studies days / journées d'études albanais

UET / 1-4 Maj 2014

**TEMA: "TË RIMENDOJMË ZHVILLIMIN DHE INTEGRIMIN"**

Konferencë ndërkombëtare shkencore / International scientific conference



Mozaiiku i Tiranës, shek. III A.D.

Adresa: Bulevardi Gjergj Fishta, Nd. 70, H.1, Tiranë, Cel. 068 20 16 616, info@uet.edu.al, www.uet.edu.al

NE JEMI KUDO!



## DSSH/ASD DITËT E STUDIMEVE SHQIPTARE II/ 2015

albanian studies days / journées d'études albanais

UET / 24-26 Prill 2015

**Tema: "TRANSFORMIMI I MADH: 25 vjet përvoja shqiptare e tranzicionit dhe demokratizimit"**

Konferencë ndërkombëtare shkencore / International scientific conference



Në partneritet me:



Mozaiiku i Tiranës, shek. III A.D.

Adresa: Bulevardi Gjergj Fishta, Nd. 70, H.1, Tiranë, Cel. 068 20 16 616, info@uet.edu.al, www.uet.edu.al